



Prishtinë, 10.07.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2798_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2692_05_25** i datës 06.05.2025;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës 05.06.2025.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, ndaj Vendimit të DMK-së për konsumatorin F. S., me shifër DPR - 14765, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2692_05_25 i datës 06.05.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 06.05.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2692_05_25 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e konsumatorit F. S., lidhur me kontestimin e faturimit me njehsorin elektrik me nr. 40140298 dhe e ka obliguar të licencuarin KESCO që të bëjë korrigjimin e faturave për periudhën 02/2024 deri në periudhën 12/2024, duke e marrë për bazë shpenzimin prej TL = 23% dhe TU = 77%.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- KESCO-ja konstaton se shpenzimi i regjistruar në njehsorin me nr. 40140298 është i saktë në matje dhe se faturimi është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor dhe koha e shpenzimit nuk ka ndikuar në saktësinë e matjes.
- Njehsori ka qenë i njëjtë në të dy periudhat, dhe është joreale të merret për bazë koha e shpenzimit vetëm në periudhën 01/2025 – 04/2025, kur edhe është konstatuar se njehsori me nr. 40140298 e ka pasur kohen gabim dhe i njëjti ka qenë i vendosur tek pika matëse edhe në këtë periudhë.



- Pas ndërrimit të njehsorit, do të ishte më e drejtë nëse shpenzimi me njehsorin nr. 40140298 t bëhej sipas shpenzimit me njehsorin e ri në periudhën 05/2025 me proporcion $TL = 65\%$ dhe $TU = 35\%$.
- Departamenti për konsumatorë në KESCO, kërkon nga Bordi i ZRrE-së, pezullimin e Vendimit të DMK-së me nr. ZRrE/DMK_V_2692_05_25 i dt. 06.05.2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të datës 05.06.2025; Vendimin e DMK-së të datës 06.05.2025; Vendimin e KESCO-s të datës 04.02.2025; Kërkesat e konsumatorit në KESCO; Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 11.02.2025; Raportin mbi Kontrollimin – Pranimin e Grupit Matës me nr. 0079093; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 0012596, të dt. 05.05.2025; fotografitë e njehsorit; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e energjisë dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s **është i pabazuar**, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, Bordi ka gjetur se, me datë 30.12.2024, Departamenti i Faturimit në KESCO i ka dërguar konsumatorit faturën me nr. 12240DPR-14765 , në vlerë prej 655.25 €. Me datë 08.01.2025, konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke e kundërshtuar këtë faturë, si dhe faturat e me hershme nën dyshimet për faturim dhe matje jo të saktë të energjisë elektrike me njehsorin me nr. 40140298. Pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, me date 04.02.2025 lëshon një Vendim, me të cilin refuzohet ankesa e konsumatorit, dhe atë duke u bazuar në listat e leximeve, rrjedhë të energjisë elektrike dhe transaksione.

Me datë 11.02.2025, i pakënaqur me këtë Përgjigje, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, duke e kontestuar në tërësi faturën 12/2024 si dhe faturimin me njehsorin elektrik nr. 40140298 per shkak te dyshimit ne matje përkatësisht per kohen tarife te shpenzimit. Konsumatori i propozon DMK-së që ankesa të aprovohet, ashtu që faturat e kontestuar të rishqyrtohen në tërësi.

Bazuar ne rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kane bërë inspektime dhe lexime të rregullta mujore, në asnjë periudhë nuk kanë evidentuar se nuk kanë qasje në pikën matëse të konsumatorit por që në disa periudha kohore me njehsorin e vjetër nr. 45614193 kanë evidentuar “sugjerim per zhvendosje pasi që njehsori është mekanik, si dhe qe vula (bllomba) është e thyer”. Bazuar ne këtë vërtetohet se konsumatori ka lexim te rregullta mujore.



Bordi duke pasur parasysh ankesën e konsumatorit për faturim të lartë si dhe mos matjen e saktë të kohës së shfrytëzimit të energjisë elektrike, me datë 11.02.2025 ka kërkuar nga KEDS që të bëjë inspektimin e pikës matëse si dhe shqyrtimin e saktësisë së matjes për njëhisorin elektrik nr. 40140298 me pajisje “ZERA”. Po të njëjtën ditë ekipet e autorizuar të KEDS-it për shqyrtime kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë bërë shqyrtimin e njëhisorit me pajisje ZERA, dhe se bazuar në matjet e ofruar rezultojnë se gabimi në matje është -0.19%. DMK konstaton se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar të matjes të përcaktuar me Kodin e Matjes së OSSH e që është +2.5%. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal vërejtjen se: *“Në kohën reale 15:28 në njëhisor figuron ora 03:02. Pika matëse mbetet në gjendje të rregullt”*. Po ashtu bazuar në fotografitë e ofruar gjatë shqyrtimit të njëhisorit vërtetohet se koha e shqyrtimit ka qenë 16:24 dhe 16:49 e që jo nuk përputhet me kohën e evidentuar në vërejtje. Bordi e ka shqyrtuar procesverbalin e shqyrtimit të njëhisorit, vërejtjen e evidentuar si dhe fotografitë e shqyrtimit të njëhisorit dhe konstaton se ekipet e KEDS-it nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat me qëllim që konsumatori të faturohet për shpenzimet reale duke mos evidentuar faktin se njëhisor elektrik nuk përmbush standardet e parapara me Kodin e Matjes së OSSH, neni 3.6 dhe 3.7 i këtij kodi, sa i përket kohës së sakte të shpenzimeve për kohën tarifore të përcaktuar edhe me Strukturën tarifore duke mos rekomanduar ndërrimin e njëhisorit elektrik. Mos faturimi i konsumatorit bazuar në shpenzimet reale është në kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njëhisor dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi duke pasur parasysh të gjeturat në procesverbalin nr.0079093 të datës 12.02.2025, me datë 23.04.2025 ka kërkuar që të bëhet ri inspektimi i pikës matëse me pajisje “ZERA”. Me datë 05.05.2025 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njëhisor kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njëhisorin elektrik nr. 40140298 me gjendje TL=021037 kWh dhe TU=018284 kWh si dhe kanë vendosur për matje njëhisorin elektrik nr. 40184150 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në vërejtje se: Ndërrimi i njëhisorit me urdhëresë se menaxhmentit. Njëhisor ndërrohet në ora 14:35. Njëhisor paraprak futet në qese dhe dërgohet në KEDS. Pason foto e kohës në njëhisor dhe gjendjet e njëhisorit në F”. Bordi ka shqyrtuar edhe fotot e dërguara me rastin e ndërrimit të njëhisorit dhe vërteton se koha e treguar në njëhisor është 02:07:03 e cila nuk përputhet me kohën reale kur është ndërruar njëhisor përkatësisht ka qenë 12 orë dallimi me çka edhe vërtetohet se njëhisor elektrik nuk ka bërë regjistrime në kohën reale të shfrytëzimit të energjisë elektrike.



Kësisoj, bazuar në analizimin e shpenzimeve Bordi vërteton se konsumatori nga periudha 02/2024 kur edhe është vendosur për matje njëhësi nr. 40140298 deri në periudhën 12/2024 ka shpenzim mesatar prej 71.89% në tarifën e lartë kurse tarifën e ulët 28.11%, kurse nga periudha 01/2025 deri në periudhën 04/2025 ndryshon gjendja, ku mesatarja e shpenzimeve në tarifën e lartë është 22.59% kurse në tarifën e ulët 77.41%. DMK duke pasur parasysh të gjitha provat e shqyrtuara, përfshi procesverbalin e kontrolles nr.0079093 datë 12.02.2025, si edhe ankesën e konsumatorit nuk ka vërejtur se ka pasur ndryshime/ndërrhyrje në piken matëse të konsumatorit nga ana e punëtorëve KEDS, pra gjendja ka mbetur e njëjtë por që vërtetohet se konsumatori nga periudha janar 2025 e tutje ka shpenzim më të ulët në tarifën e lartë dhe më të lartë në tarifën e ulët.

Andaj, duke pasur parasysh të gjeturat si dhe procesverbalet nr.0079093 datë 12.02.2025 dhe nr. 0012596 datë 05.05.2025 Bordi konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi i faturave për periudhën 02/2024 kur edhe është vendosur për matje njëhësi kontestues nr. 40140298 deri në periudhën dhjetor 2024 duke marrë për bazë mesataren e shpenzimeve të periudhës 01/2025 deri në periudhën 04/2025 e që është TL=23% dhe TU=73%.

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkycjen, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s;
- Konsumatorit **F. S.**,
- Arkivit të ZRrE-së.